



2016

Rregullore e veçantë mbi të drejtat, detyrat dhe punën e zyrtarëve sportivë

Në bazë të Statutit të Federatës së Auto Sporteve të Kosovës, Bordi Ekzekutiv i Federatës së Auto Sporteve të Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 02.04.2016 nxjerrë:

RREGULLOREN E VEÇANTË MBI TË DREJTAT, DETYRAT DHE PUNËN E ZYRTARËVE SPORTIVË NË AUTO DHE KARTING SPORTE NË KUADËR TË FASK-UT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Kjo Rregullore përcakton të drejtat dhe detyrat, mënyrën e organizimit dhe organizimin e zyrtarëve sportivë. Qëllimi i organizimit të zyrtarëve sportivë në Auto dhe Karting sport (në tekstin e mëtutjeshëm zyrtarët sportivë) është avancimi i organizimit të zyrtarëve sportivë, dhe me këtë edhe avancimi i Auto dhe Karting sportit në përgjithësi.

KOMISIONI I ZYRTARËVE SPORTIVË

Neni 2.

Zyrtarët Sportivë në Auto dhe Karting sport janë mbajtësit të licencave të vlefshme të FASK-ut. Puna dhe aktivitetet e zyrtarëve sportivë bëhet nëpërmjet Komisionit të zyrtarëve sportivë.

Neni 3.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të zyrtarëve sportivë emërohen nga Bordi Ekzekutiv i FASK-ut.

Neni 4.

Komisioni i zyrtarëve sportivë kujdeset për avancimin, punën profesionale të të gjithë zyrtarëve sportivë dhe trajnimin e zyrtarëve të ri sportivë.

Për këtë qëllim, Komisioni i zyrtarëve sportivë, çdo vit garues organizon seminare profesionale për zyrtarët ekzekutiv dhe mbikëqyrës, organizon dhe mban kurse për zyrtarët të rinj sportivë dhe për çdo gjë mban evidenca të rregullta.

Komisioni i Zyrtarëve sportivë, mban shënime të veçanta për cilësinë e detyrave të kryera, numrin e pjesëmarrjes dhe përgjegjësi në gara sportive, si dhe të dhënat tjera të nevojshme të anëtarëve të saj.

Për të gjitha vëzhgimet dhe vërejtjet, Komisioni i informon zyrtarët, dhe sipas nevojës merr masa të duhura dhe zgjedhë të gjitha ngjarjet të ndodhura.

Sekretari FASK-ut është i obliguar të dorëzon procesverbalin Komisionit të zyrtarëve sportivë, për të gjitha takimet e Komisionit sportivë të garave dhe çdo Vendim të Gjyqtarit Disiplinor, të cilat i referohen zyrtarit sportivë sipas plotfuqishmërisë të tij.

Neni 5.

Komisionin e udhëheqë Kryetari i komisionit, dhe në mungesë të tij, ky funksion kryhet nga zëvendës kryetari të cilin e emërojnë anëtarët e komisionit.

Neni 6.

Kryetari i Komisionit të zyrtarëve sportivë, përveç që udhëheq punën, ai propozon edhe rendin e ditës dhe është përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit të takimit.

Neni 7.

Kryetari dhe Zëvendës kryetari i Komisionit të zyrtarëve sportivë, mund të jenë vetëm zyrtarët sportivë me licencë të kategorisë A.

LICENCAT

Neni 8.

Licencat të cilat do të lëshohen nga FASK-u sipas kësaj rregulloreje në baze të neneve 9 dhe 11 janë:

1. Licencë ndërkombëtare dhe
2. Licencë e zyrtarit sportivë.



2016

Rregullore e veçantë mbi të drejtat, detyrat dhe punën e zyrtarëve sportivë

Neni 9.

Licencat ndërkombëtare do t'i lëshon FASK-u, të cilat do të lëshohen zyrtarëve sportivë për pjesëmarrje në punë në garat ndërkombëtare, jashtë territorit të Kosovës, e cila është e domosdoshme si kusht për pjesëmarrje në punë, në bazë të vendimit të Bordit Ekzekutiv të FASK-ut, dhe me propozimin e Komisionit të zyrtarëve sportivë.

Neni 10.

Licencat ndërkombëtare do të lëshohen zyrtarëve sportivë sipas disiplinave për ata të cilët janë licencuar si zyrtarë sportivë të kategorisë "A", për ata të cilët kanë qenë në tre vitet e mëparshme Drejtorë dhe/ose anëtarë të Komisionit Sportiv të garave ndërkombëtare, dhe të cilët kanë përfunduar me sukses seminarët e FIA-s për disiplinën përkatëse.

Kandidatët për seminare për licencë Ndërkombëtare përcaktohen nga Bordi Ekzekutiv i FASK-ut, të propozuar nga Komisioni i zyrtarëve sportivë.

LICENCA KOMBËTARE

Neni 11.

Të gjithë zyrtarët sportivë, para fillimit të çdo sezoni të garave, do të klasifikohen sipas degëve, kategorive dhe specifikave nga Komisioni i zyrtarëve sportivë.

Degët janë:

- Auto dhe
- Karting.

Kategoritë janë:

- zyrtarë sportivë i kategorisë "A";
- zyrtarë sportivë i kategorisë "B".

Ekspertet/Specialistët janë:

- Drejtori, ndihmës apo zëvendës drejtori ("D"),
- Anëtar i Komisionit Sportiv ("KS"),
- Ndihmës Drejtori për referim (NDR)
- Matësi i kohës dhe përpunuesi i të dhënave ("MK") dhe
- Komisioni Teknik ("KT").

Komisioni i Zyrtarëve sportivë është i obliguar që listat e zyrtarëve sportivë të renditura sipas degëve, kategorive dhe specifikave të dorëzon Sekretarit të FASK-ut, jo më vonë se 30 ditë para garave të para. Në bazë të listave dhe kërkesave të zyrtarëve sportivë për lëshimin e licencave, FASK-u lëshon licencë të zyrtarit sportivë.

Neni 12.

Pamja e licencës së zyrtarit sportive është:

Në pjesën e përparme është stema e FASK-ut, "Federata e Auto Sporteve të Kosovës", "Licenca e zyrtarit Sportivë", "dega", "kategoria", "specialist-ekspert", "Numri ", "Auto"/"Karting" "(kategoria)", "Emri dhe Mbiemri", "Numri ID", "e vlefshme për _____ vitin " dhe foto.

Në pjesën pasme shkruan "Hyrja dhe parkimi falas në të gjitha Auto dhe Karting gara"

Neni 13.

Gjate aplikimit për licencë, zyrtari sportivë duhet të dorëzoj kërkesën së bashku me fotokopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga MPB të RKS-se, dhe në qoftë se është aplikimi për here të parë, duhet të bashkëngjitet edhe fotografia e tij.

Neni 14.

Licencën të kategorisë "A", zyrtari sportivë mund të merr pasi që të kryen funksione ekzekutive në mënyrë aktive dhe me sukses, në tetë (8) gara kombëtare ose ndërkombëtare me licence të kategorisë "B", dhe për të cilën ka dhënë provimin përkatës.

**Neni 15.**

Provimi për marrjen e licencës të kategorisë "A" për zyrtarë sportivë përbëhet nga dy pjesë:

1. Punimi seminarik, dhe
2. Provimi.

Kërkesë për paraqitjen e provimit për licencim të Zyrtarit sportivë të kategorisë "A", paraqitet nga zyrtari sportivë i cili posedon licencë të kategorisë "B", tek Sekretari i FASK-ut. Pas pranimit të kërkesës, Komisioni i zyrtarëve sportivë, nëse janë plotësuar të gjitha kërkesat të përcaktuara në Nenin 14, vendos dhe e përcakton temën e punimit seminarik, nëpërmjet Sekretarit të FASK-ut, në afat deri në 30 ditë.

Provimi do të mbahet brenda 30 ditëve nga paraqitja e punimit seminarik para komisionit të përbërë nga tre anëtarë të emëruar nga Bordi Ekzekutiv i FASK-ut. Pas kalimit të provimit me sukses dhe me propozim të Komisionit ekzaminues, Komisioni i zyrtarëve sportivë do të lëshojë një vendim për lëshimin e licencës për zyrtarë sportivë të kategorisë "A".

Neni 16.

Zyrtarë sportivë me licencë të kategorisë "A" mund të kryejnë detyra në gara sportive si në vijim:

- Drejtor, Zëvendës dhe Ndihmës drejtori (të cilët e kanë kaluar provimin dhe kanë të shkruar në licencë ekspert të kategorisë "D"),
- Anëtar i Komisionit sportiv (të cilët e kanë kaluar provimin dhe kanë licencë të kategorisë "KS"),
- Komisioneri teknik dhe kryesues i pranimit teknik të automjeteve (të cilët e kanë kaluar provimin dhe kanë licencë të kategorisë "KT"),
- Ndihmës i drejtorit për referim.

Neni 17.

Licencë të kategorisë "B" të zyrtarit sportivë mund të marrin:

- Vozitësi që ka fituar të paktën tre (3) kampionate pas dhënies së provimit për zyrtarë sportivë para Komisionit të përbërë nga tre anëtarë të emëruar nga Komisioni i zyrtarëve sportivë, dhe
- Zyrtarët sportivë pas angazhimit aktiv dhe të suksesshëm në kryerjen e detyrave prej dy vitesh, më së paku në tetë (8) gara sportive në nivel Kombëtar me licencë të Auto-karting klubit, dhe cili e ka kaluar provimin para komisionit të përbërë nga tre anëtarë të emëruar nga Komisioni i zyrtarëve sportivë.

Me kërkesë të klubeve të FASK-ut, Komisioni i zyrtarëve sportivë do të organizojnë ligjërata, kurse dhe provime për të marrë licencë të zyrtarëve sportivë të kategorisë "B".

Me vendim të Bordit Ekzekutiv të FASK-ut do të përcaktohen afatet për paraqitjen e provimeve për të marrë licencë të zyrtarit sportivë të kategorisë "B".

Neni 18.

Provimi për marrjen e licencës të zyrtarit sportivë të kategorisë "B" do të përbëhet nga dy pjesë:

1. Punimi dhe mbrojtja e punimit seminarik, dhe
2. Provimi.

Kërkesë për provim për licencim të Zyrtarit sportivë të kategorisë "B", paraqitet nga klubi në emër të anëtarit të tyre tek Sekretari i FASK-ut. Pas pranimit të kërkesës, Komisioni i zyrtarëve sportivë, nëse janë plotësuar të gjitha kërkesat të përcaktuara në Nenin 17, vendos dhe e përcakton temën e punimit seminarik, nëpërmjet Sekretarit të FASK-ut, me një afat deri në 30 ditë.

Mbrojtja e punimit seminarik dhe provimi do të mbahen brenda 30 ditëve nga paraqitja e punimit seminarik, para komisionit të përbërë nga tre anëtarë të emëruar nga Komisioni i zyrtarëve sportivë.

Pas kalimit të provimit me sukses dhe me propozim të Komisionit ekzaminues, Komisioni i zyrtarëve sportivë do të lëshojë një vendim për lëshimin e licencës për zyrtarë sportivë të kategorisë "B".

Neni 19.

Zyrtari Sportivë me licence të kategorisë "B" mund të kryejnë këto detyra në gara sportive:

- Udhëheqësi i Komisionit të verifikimit,



- Udhëheqësi i pranimit teknik të automjetit,
- Udhëheqësi i grupeve të zyrtarëve sportivë në gara sportive (marshalle etj.),
- Matësi i kohës dhe përpunuesi i të dhënave,
- Udhëheqësi i parkingut të mbyllur (Park feme),
- Udhëheqësi i parkingut të servisimit,
- Startues – finisher (caku) të garës,
- Numërues i xhirove – rrathëve.

Neni 20.

Në kërkesë të klubeve të FASK-ut, Komisioni i zyrtarëve sportivë do të organizojnë ligjërata, kurse dhe provime, për të pajisur me licencë të zyrtarëve sportivë të klubeve të FASK-ut.

Neni 21.

Licencë të zyrtarëve sportivë të kategorisë "C" mund të marrin:

- personat të cilët me sukses e përfundojnë kursin dhe e kalojnë provimin për zyrtarët sportivë.

Neni 22.

Zyrtari sportivë me licencë të kategorisë "C" mund të kryej këto funksione në gara sportive:

- Ndhmës i zyrtarit sportivë të kategorisë "B".

Neni 23.

Zyrtarët Sportivë me licencë të kategorisë "A" në gara sportive mund të kryejnë edhe detyra të cilat janë parashikuar për kategorinë "B".

Zyrtarët sportive me licencë të kategorisë "B" në gara sportive mund të kryejnë detyrat të cilat janë parashikuara për kategorinë "C".

Neni 24.

Organizatori i garave sportive për kryerjen e funksioneve mbikëqyrëse dhe ekzekutive në gara sportive mund të angazhojë vetëm zyrtarët sportivë të kategorive përkatëse dhe valide dhe të cilat janë të evidentuara në regjistrat zyrtare të FASK-ut.

Zgjedhja e zyrtarëve nga lista, do të behet nga organizatori në konsultim me Komisionin e zyrtarëve sportivë.

Neni 25.

Ekspert/Specialist të rangut "D" dhe "KS", do të njihet zyrtarëve sportivë, të cilët kanë kaluar me sukses provimin para komisionit të formuar nga Bordi Ekzekutiv i FASK-ut.

Ekspert/Specialist të rangut "MK", do të njihet zyrtarëve sportive, të cilët kanë kaluar me sukses provimin para komisionit të formuar nga Bordi Ekzekutiv i FASK-ut, i cili përbëhet nga pjesa e provimit dhe nga pjesa praktike.

Ekspert/Specialist të rangut - "KT" do të njihet zyrtarëve sportivë, të cilët kanë kaluar me sukses provimin para komisionit të formuar nga Bordi Ekzekutiv FASK-ut, i cili përbëhet nga pjesa e provimit dhe nga pjesa praktike.

Neni 26.

Për shkak të përgjegjësisë dhe rrezikut në gara sportive, të gjithë zyrtarët sportivë në Auto dhe Karting sporte, duhet të jenë të moshës madhore, dhe nuk mund të kryejnë detyrat në gara në qoftë se janë nën moshë 18 vjeç.

Zyrtarët sportivë të cilët janë të regjistruar në FASK, mund të kryejnë funksionet mbikëqyrëse dhe ekzekutive vetëm në garat të cilat janë të regjistruara në kalendarin sportive të FASK-ut. Në garat, të cilat nuk janë të regjistruara në kalendarin sportive të FASK-ut, zyrtarët sportivë mund të kryejnë vetëm ato funksione të miratuara dhe lëshuara nga Bordi Ekzekutiv i FASK-ut.

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET**Neni 27.**

Zyrtarët Sportivë kanë të drejta dhe detyra të cilat janë të përcaktuara në këtë Rregullore.



Zyrtarët sportivë në Auto dhe Karting sport, janë të klasifikuara në dy grupe të aktiviteteve:

- Obligimet të cilat janë të lidhura me kryerjen e detyrave të zyrtarëve sportivë në Auto dhe Karting sport - Ekzekutive, dhe
- Obligimet në kontrollin dhe mbikëqyrjen e garave – Mbikëqyrja.

Neni 28.

Funksionet ekzekutive janë:

1. Drejtori,
2. Zëvendës Drejtori,
3. Ndihmës Drejtori,
4. Ndihmës i drejtorit për referim,
5. Drejtuesi i grupit të zyrtarëve sportivë,
6. Matësit e kohës dhe përpunuesit e të dhënave,
7. Drejtuesit e parkingut të mbyllur dhe parkingut të servisimit,
8. Drejtuesit e Komisionit verifikues,
9. Drejtuesit e Komisionit teknik,
10. Startuesi dhe finisheri,
11. Numëruesi i rrathëve – xhirove, dhe
12. Zyrtarët sportivë të angazhuar në organizimin e garave sportive.

Neni 29.

Detyrat e drejtorit:

1. Gjatë periudhës përgatitore punon në koordinimin dhe sigurimin e parakushteve të nevojshme për mbarëvajtjen e garës,
2. Është përgjegjës ndaj organizatorëve për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e duhur të garës sipas rregulloreve sportive, rregulloreve të veçanta dhe shtesave të rregulloreve të FASK-ut,
3. Përzjashton dhe bënë fletëparaqitjen kundër çdo vozitësit apo zyrtarit ekzekutiv i cili me sjelljet e tij e prish rrjedhën normale të garës,
4. Fillimi apo ndërprerja eventuale e garës sportive mund të behet vetëm me urdhër të drejtorit,
5. Koordinon punën e të gjithë zyrtarëve ekzekutivë,
6. Merr pjesë në takimet e Komisionit Sportiv ku raporton mbi progresin e garës dhe ofron informacione tjera, dhe
7. Kryen punë të tjera të përcaktuara me rregulloret sportive, rregulloret e veçanta dhe shtesave të rregulloreve të FASK-ut.

Neni 30.

Detyrat e Zëvendës drejtorit:

1. Është në kontakt të vazhdueshëm me drejtorin e garës dhe koordinojnë zbatimin e detyrave gjatë garës,
2. Në mungesë të Drejtorit kryen të gjitha aktivitetet e parashikuara për drejtorin e garës, dhe
3. Në rast kur drejtori nuk mund të kryej detyrat e tij në garat sportive, për ndonjë arsye, funksionin e drejtorit në garën sportive e merr ai.

Neni 31.

Detyrat e Ndihmësit të drejtorit:

1. Kryen detyra për të cilat është emëruar, dhe
2. Ekzekuton detyrat të cilat i merr nga drejtori i garës.

Neni 32.

Detyrat e Ndihmësit të drejtorit për siguri:

1. Kontrollon kushtet për mbarëvajtjen e sigurt të garës sportive, në përputhje me rregulloret, Rregulloret e veçanta, Rregulloret Shtesë dhe Elaboratin për sigurinë e garave sportive, dhe
2. Koordinon punën e shërbimeve të kujdestarëve me menaxherin e tyre, Për Ndihmës të Drejtorit për siguri mund të emërohet edhe personi i cili nuk posedon licencë të FASK-ut.

**Neni 33.****Detyrat e Ndihmësit të drejtorit për referim në gara:**

1. Formon dhe organizon punën e të gjithë grupeve të zyrtarëve sportivë,
2. Përgatit formularët e nevojshëm për punë,
3. Kontrollon punën e zyrtarëve sportivë dhe është përgjegjës për zbatimin e rregullave të garës,
4. Merr pjesë në takime, me ftesë, dhe
5. Dorëzon listën e zyrtarëve sportive të angazhuar si dhe raportin mbi punën e zyrtarëve sportivë në garë. Raporti me vlerësimet për punën e të gjithë zyrtarëve sportivë dorëzohet brenda 5 ditëve pas përfundimit të garës tek Komisioni i zyrtarëve sportive, nëpërmjet Sekretarit të FASK-ut.

Neni 34.**Detyrat e udhëheqësit të grupeve të zyrtarëve sportivë në garat sportive:**

1. Formon dhe organizon punën e grupeve të zyrtarëve sportivë,
2. Me personat kompetent kontrollon pajisjet për punë,
3. Mban kontakte të vazhdueshme me udhëheqësit e garës,
4. Siguron mjete të sinjalizimit dhe udhëzon grupet e zyrtarëve sportive si të përdorimin ato mjete,
5. Mbanë procesverbalin e të gjithë vëzhgimeve të bëra gjatë garës, sidomos në raste të parregullsive të cilat janë subjekt i ndëshkimeve dhe masave të tjera ndëshkuese, dhe menjëherë e njofton drejtorin me radio lidhje, ndërsa procesverbalin e dorëzon tek Ndihmësi i drejtorit për referim të garës, menjëherë ose pas përfundimit të garës ose pas kryerjes të një pjese të garës,
6. Nuk e braktis garën deri sa nuk përfundon mbledhja e fundit të Komisionit sportivë,
7. Merr pjesë në mbledhjet e Komisionit Sportive, nëse thirret.

Neni 35.**Detyrat e matësit të kohës:**

1. Verifikon funksionalitetin e instrumenteve matëse,
2. Mat kohën në përputhje me Rregulloret,
3. Përpunon te dhënat nga matja e kohës në trajnimin dhe garë
4. Formon listën startuese në bazë të rezultateve të kohës së matur
5. Përcakton renditjen përfundimtare në garë dhe në klasa, dhe
5. Merr pjesë në mbledhjet e Komisionit sportivë, nëse thirret.

Neni 36.**Detyrat e udhëheqësit të parkingut të mbyllur dhe parkingut të servisimit:**

1. Organizon punën e parkingut,
2. Siguron parkim të rregullt të automjeteve, organizon daljen e automjeteve për në start, bënë rreshtimin e automjeteve sipas klasave për trajnim dhe garë, identifikon vozitësit para se të dalin në start dhe kontrollon pajisjet e përcaktuara,
3. Ndan, ruan dhe siguron automjetet të cilat janë objekt i kundërshtimit, dhe
4. Merr pjesë në mbledhjet te Komisionit sportivë, nëse thirret.

Neni 37.**Detyrat e udhëheqësit të Komisionit Teknik të organizatorit:**

1. Formon Komisionin teknik të organizatorit dhe organizon punën e tyre,
2. Përgatit formularët e nevojshme dhe dokumentet e nevojshme dhe siguron mjete për punën e Komisionit Teknik,
3. Bënë kontrollin e të gjitha automjeteve dhe pajisjeve të përshkruara, para, gjatë dhe pas garës sportive,
4. Përgatit një raport komisionit sportivë të garës, për automjetet të pranuar për atë garë, dhe
5. Merr pjesë në mbledhjen e parë të Komisionit sportiv, ndërsa në mbledhjet tjera nëse thirret.

Neni 38.

**Detyrat e udhëheqësit të Komisionit verifikues:**

1. Formon Komisionin verifikues dhe organizon punën e tyre,
2. Përgatit formularët e nevojshme dhe materialet tjera të nevojshme për punë,
3. Kontrollon të gjitha dokumentet në lidhje me identitetin e vozitësve dhe dokumentet të tjera të kërkuara për pranimin në garë.
4. Përgatit raportin për vozitësit të cilët i përmbushin kriteret e përcaktuara, dhe listën e vozitësve të pranuar për garë paraqet tek Komisioni sportivë të garës, dhe
5. Merr pjesë në mbledhjen e parë të Komisionit sportiv.

Neni 39.**Detyrat e Startuesit - Finisherit:**

1. Në mënyrën e përkrahur përcakton momentin e startimit dhe lajmëron/sinjalizon vozitësit për start dhe momentin e kalimit të caktuar,
2. Është në kontakt të vazhdueshëm me drejtorin e garës, dhe
3. Përdorë sinjalizueset.

Neni 40.**Detyrat e numëruesit të xhirove - rrrathëve:**

1. Në garat rrethore me anë të sinjalizimeve të përshtatshme, informon vozitësit për numrin e mbetur të xhirove -- rrrathëve deri në fund të garës apo kohën në trajnim, dhe
2. Tregon tabela përkatëse para dhe gjatë trajnimit dhe garës me urdhër të drejtorit.

Neni 41.

Të gjithë zyrtarët ekzekutivë sportivë, në gara sportive, janë përgjegjës për punën e tyre para Drejtorit të garave, Ndhimësit të drejtorit për referim dhe udhëheqësit të tyre direkt.

Neni 42.

Funksionet mbikëqyrëse në gara sportive, mund të kryhen nga zyrtarët sportivë të kategorisë "A" dhe të cilët janë të emëruar nga Bordi Ekzekutiv FASK-ut.

Neni 43.**Funksionet mbikëqyrëse janë:**

1. Anëtarët e Komisionit sportiv të garave, dhe
2. Komisioneri teknik.

Neni 44.**Detyrat e Kryetarit të Komisionit sportiv, janë:**

1. Lajmërohet Drejtorit të garave sportive jo më vonë se para fillimit të pranimit të automjeteve dhe vozitësve në garë,
2. Udhëheqë me mbledhjet e Komisionit sportivë,
3. Propozon rendin e ditës, drejton mbledhjet dhe kujdeset për mbarëvajtjen e mbledhjeve,
4. Kontrollon dhe verifikon hartimin e procesverbalit të cilin e përgatit përfaqësuesi i organizatorit, si dhe rezultatet zyrtare të garave sportive,
5. Kontrollon nëse gara është duke u zhvilluar sipas Rregullores, Rregulloreve të veçanta dhe Rregulloreve Shtesë,
6. Kontrollon të gjithë dokumentacionin e organizatorit,
7. Kontrollon pistën për të vërtetuar nëse janë plotësuar të gjitha kushtet të Licencimit të pistave dhe elaboratit mbi sigurinë,
8. Merr pjesë në punën e Komisionit të Verifikimit dhe Komisionit teknik të organizatorit, kontrollon funksionimin e tyre dhe për vëzhgimet e tij informon Komisionin Sportiv në takimin e parë,
9. Pas përfundimit të garës dhe brenda dy ditësh ai paraqet një raport (vlerësimin e garës sportive) dhe e dorëzon dokumentacionin e plotë të garës, dhe
10. Në rast të mos ardhjes së tij në garë duhet të njoftohet Sekretari i FASK-ut.



2016

**Rregullore e veçantë mbi të drejtat, detyrat dhe punën e zyrtarëve sportivë
Neni 45.**

Detyrat e delegatit janë:

1. Duhet të lajmërohet tek Drejtori i garës jo më vonë se fillimi i pranimit të automjeteve dhe vozitësve në garë,
 2. Së bashku me Kryetarin e Komisionit sportiv, kontrollon pistën për të përcaktuar nëse janë plotësuar të gjitha kushtet sipas Licencës së pistës dhe elaboratit mbi sigurinë e pistës,
 3. Merr pjesë në punën e Komisionit sportivë,
 4. Kontrollon zhvillimin e garave sportive nëse janë në përputhje me Rregulloren, Rregulloret e veçanta dhe Rregulloret Shtesë,
 5. Nëse kërkohet nga delegati, ai duhet të përgatit raportin nën përgjegjësinë e tij për ngjarjet e veçanta në garën sportive, dhe
 6. Në rast të mungesës ose pamundësisë së ardhjes në garë duhet të informohet Sekretari i FASK-ut.
- Nëse delegati nuk vjen në garë, dhe nuk e arsyeton mungesën ose nuk e anulon të paktën 2 ditë para garës sportive, kundër tij do të behet fletëparaqitje disiplinore.

Neni 46.

Detyrat e Komisionerit Teknik janë:

1. Monitoron dhe kontrollon punën e Komisionit Teknik të organizatorit dhe ndihmon në punën e tyre,
2. Verifikon përputhshmërinë e karakteristikave teknike të automjeteve me homologim në bazë të ankesës, dhe
3. Paraqet raportin Komisionit sportiv, Drejtorit të garës dhe Komisionit Teknik të FASK-ut.

Neni 47.

Të gjithë zyrtarët e sportit të cilët janë të përfshirë në gara sportive janë personalisht përgjegjës për punën e tyre. Zyrtarëve sportive ndalohet përdorimi i telefonave celular gjatë ushtrimit të funksioneve ekzekutive, me përjashtim të rasteve kur komunikimi nëpërmjet radio lidhjeve nuk funksionon apo nëse përdoret për qëllime të tjera zyrtare.

Zyrtarit sportivë për gabimet e tij, ose për mos aplikimin e Rregulloreve në gara sportive, Komisioni i zyrtarëve sportivë mund në bazë të fakteve të vendosë ndalesën e kryerjes së detyrave në një numër të caktuar të garave.

Neni 48.

Zyrtarët sportivë janë të detyruar të zbatojnë rregullat në mënyrë strikte për të siguruar funksionimin e duhur të garave sportive. Çdo sjellje joprofesionale, jo sportive dhe sjellje jo të përshtatshme të një zyrtari sportivë në garë, mund të sanksionohet si nga organet disiplinore ashtu edhe nga Komisioni i zyrtarëve sportive. Çdo masë disiplinore duhet të publikohet. Komisioni i zyrtarëve sportive, do të mban evidencë të rregullt për masat disiplinore të shqiptuara për çdo zyrtarë sportivë.

Kompensimi për punë

Neni 49.

Për kryerjen e detyrave në gara sportive për punën e çdo zyrtarit sportive takon rimbursimi i shpenzimeve si dhe shpërblimi për punë - Tarifa e zyrtarit.

Shuma e tarifës së zyrtarit përcaktohet nga Bordi i Drejtoreve ekzekutive të FASK-ut.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 50.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen sipas të njëjtës procedurë e cila vlen edhe për nxjerrjen e saj nga ana e Bordit të Drejtoreve ekzekutive të FASK-ut.

Te drejtën e shpjegimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje, e ka Bordi i Drejtoreve ekzekutiv të FASK-ut.

Neni 51.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj me 02.04.2016

FEDERATA E AUTO SPOTREVE TE KOSOVES

Ismet Rexhepi, Kryetar i FASK-ut

